

VENDIM
Nr.192, datë 10.4.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË GRAMSHIT TË MJEDISEVE TË ISH-SHTËPISË SË USHTARAKËVE, TË ISH-SHTABIT TË REPARTIT USHTARAK 9920 DHE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIT NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-Shtëpisë së Ushtarakëve dhe të ish-shtabit të repartit ushtarak 9920 në Gramsh, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Gramshit, për strehim dhe kthim në fond banese.

2. Mjediset e degës së mobilizimit në Gramsh, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojnë në pronësi bashkisë së Gramshit, për t’u përdorur për nevojat kulturore-shoqërore të këtij qyteti.

3. Pronat me numrat rendorë 342, “Ish-Shtëpia e Ushtarakëve”, 340, “Ish-shtabi i repartit ushtarak 9920” dhe 341, “Dega e mobilizimit” në Gramsh, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

4. Bashkisë së Gramshit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetari i bashkisë së Gramshit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano